



RTV 21  
Afërdita KELMENDI  
Drejtoreshë  
Prishtinë

Ankesa Nr. 2017/52 KPM vs RTV 21  
Ref:1708/770/KPM/am

### VENDIM

**Lidhur me Ankesën nr. 2017/52 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër RTV 21  
("Pala Përgjegjëse")**

---

#### Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 28 gusht 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) është përgjegjës për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, me anë të të cilit përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore. Duke u bazuar në kapitullin VIII të këtij Ligji, KPM ka nxjerrë udhëzuesin për të ndihmuar të licencuarit që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Zgjedhje.
3. KPM me datën 29 maj 2017 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Udhëzuesin për zbatimin e Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073, me qëllim që t'i ofrohen udhëzime për respektimin e dispozitave ligjore gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore.
4. KPM bazuar në monitorimet që janë bërë gjatë fushatës zgjedhore për pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Ligjin për Zgjedhjet Nr. 03/L-073, ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar një spot politik të AAK-së ku është vërejtur prezenca e fëmijëve, duke bërë kështu shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
5. KPM, gjithashtu bazuar në këto monitorime ka gjetur se Pala Përgjegjëse në ditën e zgjedhjeve ka transmetuar konferencat e koalicionit PAN dhe koalicionit LAA.

#### Analiza Ligjore

6. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073.



7. Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka transmetuar spot politik në të cilin ishin të përfshirë fëmijët dhe me këtë ka bërë shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

*“Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.”*

8. Pala Përgjegjëse gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës ka transmetuar konferenca të subjekteve politike të certifikuar dhe me këtë ka bërë shkelje të Nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

*“Asnjë person ose medium nuk transmeton ose publikon çfarëdo material që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.”*


Pala Përgjegjëse në bazë të këtij neni e ka për obligim që të mos publikojë çfarëdo material që i takon aktivitetit të fushatës gjatë periudhës që fillon njëzetekatër (24) orë para hapjes së vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të vendotimeve.

### Vendimi

9. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073.
10. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 9, paragrafi 7, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03 dhe shkelje të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme Nr. 03/L-073.

### E drejta për Ankesë

11. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
12. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

  
Adnan MEROVCI  
Kryetar



10.08.2017  
Datë